

TIRANE MË 05.02.2024

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"2FM" SHPK

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe të Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit" me vullnetin e tij të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e Statutit vendosi të formoj shoqërinë:

I. THEMELIMI

Neni 1

Ortakët themelues

- 1.1 Shoqëria " 2FM "SHPK themelohet nga ortakët z.Florjan Merja, shtetase shqiptar, lindur më 28.12.1981, në Vore dhe banues në Tirane, me numër karte identiteti I11228045S, z.Edmond Duro, shtetase shqiptar, lindur më 05.01.1982, në Çorovode dhe banues në Tirane, me numër karte identiteti I20105149F, , z.Faik Bani, shtetase shqiptar, lindur më 28.05.1988, në Permet dhe banues në Tirane, me numër karte identiteti I80528030I

II. EMRI. SELIA. FORMA LIGJORE

Neni 2

Emri i shoqërisë

- 2.1 Emri i shoqërisë është " 2FM " SHPK.

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), në bazë të ligjit Nr.9901,date14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria " 2FM " SHPK, do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Ligjin nr. 9901, date14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " si dhe dispozitat e tjera të Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një kohë mbi 10 vjet .
- 5.2 Veprimtaria e Shoqërisë fillon që nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të

_____ (1) _____

Biznesit, Tiranë.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Konferenca e Pezes, Ish Misto Mame, ZK.8240, nr. i pasurisë 5/269, Kodi Unik; 8240008094.
- 6.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakëve të shoqërisë.
- 6.3 Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë, filiale ose/dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë vendit.
- 6.4 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera ekzistuese ose në shoqëri që në të ardhmen do të zhvillojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij me vendim të ortakëve të saj.

Neni 7
Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj që do të përdoret nga administratori.
- 7.2 Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Ortakët e shoqërisë, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

Neni 8
Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - 1- "Import-eksport, tregeti me shumice e pakice të mallrave të ndryshme, punime gipsi etj. Punime dekorative me baze gipsi. Import - eksport me shumice e pakice të lendeve të para, materialeve të ndërtimit, pajisjeve, makineri etj. Tregti me shumice dhe pakice të bojërave të murit dhe aksesoreve të lysterjes. Shërbime të lysterjeve të ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Muratura, Suvatime dhe Gipse dhe sisteme Kapot etj. Tregti të materialeve të Gipsit

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar është 20,000 (njëzet mijë) lekë, i ndarë në 3 kuota si më poshtë:
 1. Z. Florjan Dilaver Merja, shtetas shqiptar, lindur në Vore, më 28.12.1982, banues në Tiranë, mbajtës i ID me nr I11228045S me 1 kuotë me vlerë 10,000 (dhjet mijë) lekë dhe me pjesëmarrje të 50% të kuotave të kapitalit.
 2. Z. Edmond Servet Duro, shtetas shqiptar, lindur në Çorovodë, më 05.01.1982, banues në Tiranë, mbajtës i ID me nr I20105149F me 1 kuotë me vlerë 5,000 (pesë mijë) lekë dhe me pjesëmarrje të 25% të kuotave të kapitalit.
 3. Z. Faik Malko Bani, shtetas shqiptar, lindur në Permet, më 28.05.1988, banues në Tiranë, mbajtës i ID me nr I80528030I me 1 kuotë me vlerë 5,000 (pesë mijë) lekë

dhe me pjesëmarrje të 25% të kuotave të kapitalit.

9.2 Kapitali do të derdhet tërësisht me aktin e themelimit. Asambleja mund të marrë vendim për rritje të kapitalit, duke përcaktuar afatin, kushtet dhe modalitetet. Kapitali mund të shtohet nëpërmjet akordimit të pasurive në natyrë apo kredite.

Në interesin financiar të shoqërisë ortakët mund të kryejnë derdhje pa interes në llogari kapitale, si edhe financime me apo pa interes, duke respektuar ligjin.

Shoqëria mund të procedoj me rimbursime të financimit, te pjesshme apo totale, mbledhjen e fondeve nga ortakët/u, me të drejtë rimbursimi, duhet tu drejtohet ekskluzivisht subjekteve që janë në perputhje me kërkesat e ligjit dhe rregulloreve, sipas rregullave të autoriteteve perkatese.

Neni 10

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar

- 10.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial.
- 10.2 Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të tretëve me vendim të ortakëve të shoqërisë. Pjesët e kapitalit transferohen në rrugë trashëgimnie pasi të jetë marrë vendimi i Ortakëve lidhur me kalimin e pjesëve të kapitalit tek trashëgimtarët.

Neni 11

Zmadhimi / Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 11.1 Ortakët e shoqërisë mund të zmadhojnë ose zvogëlojnë kapitalin themeltar me vendim . Zvogëlimi i kapitalit themeltar do të kryhet brenda kufijve të lejuar nga ligji.

11.2 ORGANET E SHOQËRISË

Neni 12

Asambleja e Ortakëve


Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

- 12.1 Asambleja e Ortakëve drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Mbledhjet e Asamblesë janë të zakonshme.

Neni 13

Asambleja e Zakonshme

- 13.1 Asambleja e zakonshme vendos në cdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo merr të gjitha vendimet (emërimi dhe shkarkimi i administratorit/ëve, miratimin e bilancit të shoqërisë, etj.) me përjashtim të atyre vendimeve që në bazë të ligjit ose Statutit janë në kompetencë të Asambesë së Jashtëzakonshme.
- 13.2 Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortakët e saj me 51% të votave.



Neni 14
Thirrja dhe Përfaqësimi në Asamble

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mund të thirret në cdo kohë nga:

- Administratori;
- Ortakët.
- E të tjerë konform ligjit

Neni 15
Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve

- 15.1 Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër të njoftuar nga administratori/njëri prej administratorëve.
- 15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande, dhe postë tjetër të regjistruar, të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Neni 16
Marrja e vendimeve

- 16.1 Vendimet merren nga ortakët e saj me 51% te votave.

Neni 17
Administrimi

- 17.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose nga një grup administratorësh që caktohet nga Asambleja e Ortakëve.
- 17.2 Administratori nuk është detyrimisht ortak i shoqërisë.
- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësoj shoqërinë dhe të drejtoj punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Ortakëve.
- 17.4 Administratori është solidarisht përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendës.
 - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendës, veçanërisht në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera të kreditit, për hapjet e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
 - përgatitjen e mbledhjeve të Asambleve të Ortakëve ;
 - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vetë ose emërimin e një kontabilisti të miratuar ose të një eksperti kontabël;
 - përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që ka;
 - lidh kontrata pune dhe i zgjidh ato sipas rastit;
 - Zhvillon veprimtari të tjera të cdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
- 17.5 Shoqëria do të administrohet nga administratori Z.Edmond Duro, lindur në Çorovode, mbajtës i ID me nr I20105149F i cili emërohet në këtë detyrë për një afat kohor prej 5 (pesë) vjet.

Neni 18
Viti financiar

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar në 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 19
Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

- 19.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve dhe i paraqitet organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 19.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën Shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të vecanta në valutë.
- 19.3 Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët, institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 20
Të ardhurat. Dividendi

- 20.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezerve për realizimin e objektit të saj.
- 20.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të terhiqen nga ortakët e shoqërisë.

Neni 21
Likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit, nëse:
- gjendja ekonomike në Shqipëri nuk do të lejojë vazhdimin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - Asambleja e Ortakëve, vendos të prishë shoqërinë.
- 21.2 Në mënyrë që të ndërmerret procedurat e likuidimit, Asambleja e Ortakëve emëron një likuidator ose një grup likuidatorësh.
- 21.3 Likuidatori/likuidatorët raportojnë mbi gjendjen e zërave të aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve shqyrton bilancin përfundimtar dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

Neni 22
Dispozita mbyllëse

- 22.1 Ky Statut hartohet në 5 (pesë) kopje me fuqi të njëjtë ligjore në gjuhën Shqipe, për tu depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit e për tu shpërndarë në organet Kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

TIRANE MË 05.02.2024

O R T A K Ë T E S H O Q Ë R I S Ë

Z. Florjan Merja
Florjan Merja

Z. Edmond Duro
Edmond Duro

Z. Faik Bani
Faik Bani